

PËRGGJIGJIU POZITIVISHT



DEMOKRACISË

TË MËSOJMË PËR DEMOKRACI

AURORË (15), GENTIAN (13), FLORENT (11), DIJON (14)



Nxënësit e shkollës „Rilindja“ për të gjithë lexuesit e kësaj gazete kanë shkruar shumë gjëra të rëndësishme për tema të ndryshme. Do të merrni shumë informata për demokracinë nga ne. Ndërsa, nga dy grupet e tjera do të mësoni për zgjedhjet dhe Kuvendin. Lexim të këndshëm

Demokracia është sistem i qeverisjes, prejardhja e së cilës daton shumë kohë më parë, më saktësisht që nga viti 507 p.e.s. Edhe pse demokraci, duhet të theksojmë që forma e parë e saj ishte shumë më ndryshe nga kjo që ne e gëzojmë sot. Kishte dallime më mes grave dhe burrave, mes të pasurve dhe të varfërve, mes të rinjëve dhe të moshuarve, etj. Të gjitha këto sot nuk janë të pranishme si më parë. Edhe pse mendojmë që për të mos ekzistuar këto dallime duhet shumë kohë. Gjithashtu, kërkohet përkushtimi i të gjithë qytetarëve anë e mbanë globit.

Kur jemi tek dallimet, shoqja jonë Aurora na tregoi një rast ku në shkollën që ka qenë më parë, shokët dhe shoqet e saj e kanë përqeshur një vajzë e cila kishte nevoja të veçanta. Ajo tha: „Çdo herë që ajo merrte fjalën, e gjithë klasa ia plaste gazit, deri në momentin kur kujdestarja e klasës dëgjoi rastin dhe ne biseduam mes vete për këtë çështje. Nga ai moment më asnjëherë nuk është përsëritur kjo, dhe të gjithë filluan ta respektonim atë. Edhe ajo është njeri, si të gjithë ne“, përfundoi Aurora. Këtë shembull e treguam që të kuptojmë që nëse ndonjëri prej nesh dëgjon raste të tilla, duhet të reagojmë dhe të tregojmë, sepse këto veprime janë në kundërshtim me demokracinë.

Të kalojmë pak tek disa fakte për këtë sistem. Fjala

demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ qeverisje. Kemi dy lloje të demokracisë: e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Kosova ka demokraci përfaqësuese, sepse vendimet për të gjithë ne i marrin deputetët, të cilët i votojnë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. Vota është e lirë dhe e pa imponueshme. Këtë e kërkon demokracia.

Për sa i përket demokracisë së drejtpërdrejtë, qytetarët këtu nuk i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, mirëpo vendimet merren direkt nga qytetarët. Këto lloj sistemi e ka shteti i Zvicrës.

Për ne si nxënës nuk ka rëndësi se cila formë e demokracisë është e pranishme, përderisa qëllimi i saj është mirëqenia e përbashkët e qytetarëve. Për këtë e duam demokracinë. Ajo na falë ngrohtësi dhe barazi.



Le ta prijë e mbara vendin tonë

Demokracia është temë për të cilën mund të flasim me ditë të tëra, sepse në një mënyrë apo tjetrën ajo është përditshmëria jonë. Nëse dëshirojmë të flasim për të drejtat, duhet patjetër t'i referohemi edhe demokracisë. Nëse flasim për barazinë, prapë duhet të përmendim demokracinë. Nëse flasim për lirinë, prapë nuk mund të kalojmë pa e përmendur atë.


Pse qenka e rëndësishme të mësojmë ne për demokracinë?

Po si të mos mësojmë për këtë sistem, kur çdo element që e cekëm më lart është në lidhje të ngushtë me të? Nëse nuk do të kishim demokraci, ne do të mësonim për të vetëm në libra dhe nuk do të kishim mundësi që ta jetësojmë atë. Është shumë ndryshe

kur vetëm mëson për një gjë, por nuk e vë dot në funksion dhe është krejtësisht ndryshe kur e mëson, por po ashtu edhe e realizon atë gjë.

Ne, qytetarët e Kosovës jemi shumë me fat që vendi ynë e ka këtë sistem. Falë tij, të gjithë qytetarët ndjehen dhe janë të lirë të jenë vetvetja, duke ekzekutuar vlerën më të madhe të demokracisë: lirinë. E thamë vendi ynë, sepse edhe pse jetojmë në këtë shekull, ka ende shumë shtete që qytetarët diskriminohen për çështje të ndryshme.

Prandaj, ne mendojmë që është shumë e rëndësishme të mësojmë për demokracinë dhe t'i a dijmë vlerën asaj. Ne duhet të punojmë për të dhe t'i ndihmojmë zhvillimit të saj.



Këtu kemi paraqitur disa shokë të komuniteteve jo shumicë. Në vizatimin e parë kemi paraqitur një vajzë e cila mendon se iu është bërë një e padrejtë. Ajo gëzon të drejtën ta ngris zërin kur mendon se iu është bërë ndonjë padrejtësi. Ndërsa, në vizatimin e dytë kemi paraqitur një djalosh, i cili na fton të lexojmë për të drejtat e tij

Deri tash folëm për demokracinë dhe të mirat e pa-fundme që ky sistem na ofron. Në këtë pjesë, dëshirojmë të tregojmë edhe për një të mirë tjetër, që është prania dhe respektimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. Jo në të gjitha vendet e botës, qytetarët e komuniteteve jo shumicë trajtohen ashtu siç i trajtojmë ne qytetarët e vendit tonë. Qytetarët e komuni-

teteve jo shumicë parimisht janë të njëjtë me të gjithë ne. Ata janë njerëz të cilët jetojnë, rriten, edukohen dhe veprojnë në Kosovë. Çka i bën të dallueshëm nga ne është vetëm etnia e tyre dhe asgjë më shumë. E ne nuk jemi qytetarë që gjykojmë vetëm prej etnisë së tyre. Çdo gjë që e gëzon komuniteti shumicë e gëzojnë edhe komunitetet jo shumicë. Kjo është demokraci!

GARANTIMI I TË DREJTAVE TONA

EDON (13), BUJAR (14), ANITA (14), RINOR (11)



Ligjet, rregulla të cilat ndikojnë në jetën e secilit. Në këtë artikull, grupi ynë iu shpjegon më shumë rreth ligjeve, duke filluar me një shembull

Lea dhe Leoni janë dy fëmijë 12 vjeçarë, të cilët kanë shumë dëshirë të shkojnë në shkollë dhe të mësojnë gjëra të ndryshme. Mirëpo, dëshira e tyre nuk mund të realizohet, sepse ata nuk jetojnë në një shtet demokratik. Ata kanë shumë talent në muzikë, por në shtetin e tyre nuk u mundësohet shkollimi dhe nuk janë të barabartë me të tjerët. Lea dhe Leoni ndjeheshin të diskriminuar nga shoqëria dhe nuk kishin as aftësitë elementare, siç janë leximi dhe shkrimi. Kështu do të ishte një vend pa mundësi për shkollim të mirëfilltë.

Në anën tjetër, Ana dhe Andi e kanë të drejtën e shkollimit, si gjithë të tjerët. Kjo sepse ata jetojnë në një vend demokratik, ku ka liri dhe barazi. Ligjet u mundësojnë të realizojnë edhe ëndrrat e tyre në të ardhmen. Po të mos ishte demokracia, nuk do të ishim të lirë të bëjmë gjërat që ne i dëshirojmë. Të gjitha të drejtat, pra, i kemi të garantuara me ligj. Siç po shihet, ligjet kanë ndikim shumë të madh në jetën tonë, prandaj është e rëndësishme të dijmë se ku miratohen ato. Kuvendi, i cili ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“, është institucioni më i lartë legjislativ. Në këtë institucion merren vendime për ligjet. Deputetët, të

cilët janë përfaqësuesit e popullit miratojnë ose nuk miratojnë këto ligje.

Përveç këtij funksioni, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera, të cilat janë: funksioni kontrollues dhe funksioni përfaqësues. Funksioni kontrollues do të thotë se ai kontrollon punën e Qeverisë, një tjetër institucion i rëndësishëm për jetën tonë. Ndërsa, me funksionin përfaqësues nënkuptojmë detyrën e Kuvendit për të përfaqësuar popullin.

Këto ishin disa fakte rreth institucionit ku merren vendime të rëndësishme për të gjithë qytetarët.

Shpresojmë që nga ky artikull, ju të dashur lexues, keni kuptuar rolin e Kuvendit në jetën tonë. Ne kemi një mesazh për ju: t'i respektojmë ligjet, të jemi të përgjegjshëm dhe të jemi tolerant në mënyrë që të jetojmë një jetë paqësore.



Përfaqësuesit e së ardhmes

ZGJEDHJET TONA DHE PESHA E TYRE

DONITË (14), MEGZON (13), EDONA (14), ADNAN (13)



Ne zgjedhim çdo ditë, por në procesin zgjedhor zgjedhim një herë në 4 vjet

Ne si të rinjë që jemi, shumë shpesh ndeshemi me sfida të ndryshme që na paraqiten çdo ditë të jetës sonë. Këto sfida na bëjnë neve më të fortë për sa i përket zgjedhjeve tona në të ardhmen.

Edona është një vajzë e klasës sonë, e cila kohëve të fundit ka një shqetësim për sa i përket dëshirave të saj. Ajo e don tej mase pikturën dhe me të vërtetë punimet e saj janë shumë të bukura. Këtë mund ta vëreni edhe ju përmes vizatimeve të punuara nga ajo edhe në këtë artikull. Por, Edonës gjithashtu i pëlqen edhe mjekësia. Si person human që është, ka dëshirë të zjarrtë t'iu ndihmojë personave në nevojë dhe të cilët kanë sëmundje të ndryshme .




Gazetarë të suksesshëm

Asaj iu është dashur që të bëjë një zgjedhje përfundimtare në mes të këtyre opsioneve, apo dëshirave të saj. Ajo thotë se kur bën dy gjëra të ndryshme në të njëjtën kohë, nuk mund t'i bësh ashtu si duhet. Ky mendim e ka bërë Edonën që të bëjë zgjedhjen e saj, e cila është mjekësia .

Ne jemi shpesh konfuz për shumë gjëra, kur është fjala për zgjedhjen e gjërave të cilat janë të rëndësishme për ne. Por, shumë shpejt do të vie dita që edhe ne si të gjithë qytetarët e tjerë, të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Kjo do të thotë se edhe ne do të jemi pjesëmarrës në përzgjedhjen e personave, të cilat do të na përfaqësojnë neve si qytetarë të shtetit më të ri në Evropë.

Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhet kryetari i komunës dhe asamblistët komunal, të cilët përfaqësojnë qytetarët e komunës së tyre. Kurse, në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët të cilët përfaqësojnë popullin e Kosovës në Kuvendin e Kosovës.

Ne e kuptuam lidhshmërinë e zgjedhjeve tona të përditshme me temën të cilën e diskutuam sot. Mirëpo, zgjedhjet bëhen varësisht nga rrethanat ku jetojmë, mundësitë të cilat na ofrohen në jetë dhe mbi të gjitha rëndësisë që ato kanë për ne. Kjo është e tëra për sa i përket procesit zgjedhor dhe rëndësisë së tij.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Rilindja“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI, VII, VIII & IX
Website: www.demos-ti.org Vendi: Hertzicë, Podujevë